ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Qendrore e Prokuimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/26300-26-8160-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**AJANI & ADAMI SH.P.K.**
NUI	**810863557**
Adresa	**Mark Isaku, Nr.30**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**+38344321000**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Fatbardh Maloku**
Adresa elektronike	**adams.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**09.11.2026**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura

Anekes prane Autoriteit Kontraktues : Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP)

Aktiviteti: "Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura"

Nr. i prokurimit: 201/26300-26-8160-2-2-1

Lënda: Kundërshtim i eliminimit sipas letrës standarde B42 të datës 26.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Anekes prane Autoriteit Kontraktues : Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP)

Aktiviteti: "Larja e automjeteve për nevojat e Agjencive të Pavarura"

Nr. i prokurimit: 201/26300-26-8160-2-2-1

Lënda: Kundërshtim i eliminimit sipas letrës standarde B42 të datës 26.10.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues: **Agjencia Qendrore e Prokruimit**

Shkeljet e dispozitave të LPP janë si me poshtë :

Neni 1 - Qëllimi I LPP-se

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret per Dhenien e kontrates

Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me rastin e mos rekomanidimi te kompanisë tonë per dhenje te kontrates Autoriteti Kontraktues **Agjencia Qendrore e Prokruimit** *ka bërrë këto shkelje:*

1. Shkeljet e dispozitave të LPP:

-

Me daten 26.10.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin tuaj, ku keni rekomanduar per

kontrat **EDA CARS AUTOMOBILE L.L.C** i cili nuk i plotson kriteret e kerkuara te percaktuar nga ana juaj ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate:

-

Neni 1 - Qëllimi i LPP-se

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Ndersa Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 6 pasi ka rekomanduar per kontrate nje Operator Ekonomik i cili nuk i ka plotsuar kriteret e kerkuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim per kontrate, qe do te thote nuk eshte sipas dispozitave te LPP-se.

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Autoriteti Kontraktues duke na Diskriminuar ne si Operator Ekonomik te pergjegjshem dhe kane zgjedhe ta shperblejn per kontrate nje Operator qe nuk i plotson kriterete e

kerkuata ne Dosje te Tenderit dhe ne Njoftim per kontrate.

I nderuar Autoritet Kontraktues,

AJANI & ADAMI SH.P.K., në cilësinë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të lartcekur, parashtron këtë kërkesë për rishqyrtim ndaj vendimit të datës 26.10.2026, me të cilin oferta jonë është eliminuar dhe kontrata i është dhënë EDA CARS AUTOMOBILE L.L.C. Kërkojmë që vendimi të rishqyrtohet në tërësi, të verifikohen dokumentet origjinale dhe baza faktike e eliminimit, si dhe të nxirret vendim i arsyetuar për secilin pretendim të paraqitur më poshtë.

I. Gjendja faktike dhe interesi juridik

Sipas Njoftimit B58 të datës 26.10.2026, oferta e AJANI & ADAMI SH.P.K. është në vlerë prej 17,810.00 euro, ndërsa oferta e operatorit të rekomanduar EDA CARS AUTOMOBILE L.L.C. është në vlerë prej 21,047.90 euro. Pra, oferta jonë është më e ulët për 3,237.90 euro. Kjo diferencë nuk e zëvendëson detyrimin për përmbushjen e kërkesave të pranueshmërisë, por tregon se vendimi duhet të mbështetet në verifikim të saktë, të plotë dhe të njëtrajtshëm të dokumenteve, në mënyrë që të mos përjashtohet një ofertë më e ulët pa bazë të mjaftueshme.

Në letrën B42, AQP arsyeton se certifikata e ATK-së e dorëzuar më 22.10.2026 tregon se operatori është në marrëveshje për shlyerjen e borxheve dhe se marrëveshja e paraqitur mban datën 19.10.2026, pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë

II. Pretendimet për rishqyrtim

1. Kërkohet verifikim i plotë i dokumentacionit tatimor

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të

Ligjit Prokurimit Publike, siç është e cekur në Pjesën, do të dorëzohen në formë të Aneksit.

2. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore

te lëshuar nga Gjykata Kompetente- kërkohet origjinali ose kopje e vërtetuar jo më e vjetër

se 90 ditë prej datës se njoftimit për kontratë, (mos dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të

diskualifikoj tenderin tuaj, ***por duhet dorëzohet nga OE te cilit synohet dhënia e kontratës).***

3 . Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e

tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit prej datës se njoftimit për kontratë, (mos

dorëzimi i kësaj dëshmie nuk do të diskualifikoj tenderin tuaj, ***por duhet dorëzohet nga OE te***

cilit synohet dhënia e kontratës)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim-kërkohet origjinal. 2. Vërtetimi nga Gjykata Themelore - kërkohet

origjinali ose kopje e vërtetuar noterizuar. 3. Vërtetimi nga ATK - kërkohet origjinal apo kopje

2. Detyrimi për vendim të individualizuar dhe të arsyetuar

Kërkojmë që AQP të identifikojë saktësisht dispozitën e dosjes së tenderit dhe dispozitën ligjore që e konsideron të papërmbushur, të vlerësojë certifikatën e ATK-së së bashku me marrëveshjen dhe çdo dëshmi tjetër relevante, si dhe të shpjegojë në mënyrë të individualizuar pse këto dokumente provojnë mosplotësimin e kërkesës së pranueshmërisë. Arsyetimi duhet të tregojë se është shqyrtuar gjendja faktike e plotë dhe jo vetëm një element formal, përfshirë datën efektive dhe statusin e detyrimeve tatimore.

Kërkojmë gjithashtu që AQP të verifikojë në dosjen elektronike kohën e dorëzimit të secilit dokument, përmbajtjen e plotë të certifikatës së ATK-së dhe marrëveshjes, si dhe procesverbalin e vlerësimit. Kjo do të mundësojë kontrollin e ligjshmërisë së vendimit dhe do të shmangë çdo mospërputhje ndërmjet dokumenteve të administruara dhe arsyetimit të dhënë në letrën B42.

3. Barazia në trajtim, transparenca dhe ekonomiciteti

Në bazë të parimeve të LPP-së, të gjithë operatorët duhet të vlerësohen në mënyrë të barabartë dhe sipas të njëjtave kërkesa të publikuara. Kërkojmë konfirmim se të njëjtat kërkesa të pranueshmërisë dhe të njëjtat standarde të verifikimit janë zbatuar ndaj operatorit të rekomanduar, si dhe që dokumentet e tij të pranueshmërisë të jenë kontrolluar sipas të njëjtave kritere. Ky pretendim nuk është pohim se operatori tjetër ka mangësi;

është kërkesë për verifikim të dokumentuar dhe të njëtrajtshëm të dosjes.

Duke qenë se oferta jonë është 3,237.90 euro më e ulët, një vendim i ligjshëm dhe i bazuar në prova është me rëndësi edhe për përdorimin ekonomik të fondeve publike.

III. Praktika e OSHP-së dhe vendimet e bashkëngjitura

Kërkojmë që të merren parasysh dokumentet e bashkëngjitura, përfshirë vendimin OSHP 2025/0965 dhe raportin përkatës të ekspertit, si dhe raportin e ekspertit dhe vendimin OSHP 2026/0109. Këto lëndë kanë trajtuar çështje të dokumentacionit të ATK-së dhe marrëveshjeve për shlyerjen e borxheve. Në vendimin OSHP 2025/0965 ankesa u aprovua dhe njoftimi për dhënie të kontratës u anulua e lënda u kthye në rivlerësim; në vendimin OSHP 2026/0109 u mor gjithashtu vendim për anulim të njoftimit dhe kthim në rivlerësim. Këto vendime nuk garantojnë rezultat të njëjtë për këtë rast, por tregojnë rëndësinë e shqyrtimit të dokumentacionit dhe të arsyetimit të plotë.

Vendimi OSHP 2026/0045 – parimi për datën e certifikatës tatimore dhe kufijtë e zbatimit

Bashkëngjisim dhe kërkojmë të shqyrtohet edhe Vendimi i OSHP-së nr. 2026/0045, i datës 13.03.2026, lidhur me aktivitetin “Furnizim me grurë për nevojat e Rezervave Shtetërore për vitin 2025”. Në pjesën arsyetuese, faqet 31–32 të dokumentit të bashkëngjitur, Paneli Shqyrtues trajton nenin 65 të LPP-së dhe dallon ndërmjet (a) datës kur është lëshuar certifikata tatimore dhe (b) periudhës kohore të pranueshmërisë që certifikata duhet të dëshmojë.

Në atë vendim, OSHP konstaton se operatori ekonomik nuk mund të eliminohet vetëm për faktin se vërtetimi tatimor nuk është lëshuar brenda 90 ditëve para publikimit të njoftimit për kontratë. Vendimi thekson, megjithatë, se sipas nenit 65 paragrafi 5 të LPP-së, pranueshmëria tatimore lidhet me periudhën që menjëherë paraprin datën e publikimit të njoftimit për kontratë, dhe operatori duhet të ketë qenë i pranueshëm në atë datë. Për këto arsye, ky vendim citohet vetëm për këtë dallim juridik dhe jo si provë se një marrëveshje e lidhur pas publikimit të njoftimit e shëron automatikisht gjendjen e mëparshme tatimore.

Për rastin konkret, njoftimi për kontratë është publikuar më 24.09.2026, ndërsa dokumenti i marrëveshjes i përmendur nga AQP mban datën 19.10.2026. Prandaj, kërkojmë që AQP të verifikojë me ATK-në gjendjen tatimore të operatorit në periudhën relevante dhe natyrën juridike të marrëveshjes, pa e barazuar automatikisht datën e lëshimit të certifikatës me datën kur ka ekzistuar ose jo gjendja e pranueshmërisë.

Dispozitat që lidhen me këtë arsyetim, sipas tekstit të vendimit të bashkëngjitur, janë: neni 65 paragrafi 5 i LPP-së (periudha relevante e pranueshmërisë); nenet 104 paragrafët 1 dhe 4 të LPP-së (të përmendura në bazën e vendimmarrjes së OSHP-së për shqyrtim të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim); dhe neni 117 i LPP-së (i cituar nga Paneli si bazë për vendimin). Për kërkesën aktuale për rishqyrtim, mbetet gjithashtu relevant neni 108/A

i LPP-së.

Në mbështetje të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar, paraqesim këtë Ankese pranë Autoriteti tuaj si kundërshtim mbi eliminimin tuaj, për arsyet si vijon:

• **Më 08.05.2026 operatori ka lidhur marrëveshje me ATK-në për pagesën e detyrimeve me këste; ekziston vërtetimi i ATK-së i datës 01.07.2026.**

• **AQP ka publikuar njoftimin për kontratë më 24.09.2026; hapja e ofertave është zhvilluar më 15.10.2026.**

• **Më 19.10.2026 është lidhur marrëveshje tjetër me ATK-në, ndërsa më 22.10.2026 është lëshuar vërtetimi i ri i ATK-së, përpara publikimit të njoftimit B58 më 26.10.2026.**

• Në letrën B42 të datës 26.10.2026, AQP arsyeton eliminimin me datën 22.10.2026 të vërtetimit dhe datën 19.10.2026 të marrëveshjes, duke iu referuar edhe interpretimit nr. 6 të KRPP-së dhe praktikës së OSHP-së, pa identifikuar vendime konkrete.

Bazuar ne Nenin 25.9 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në versionin e dokumentit të bashkëngjitur, përcakton:

"**Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së."**

Po ky paragraf parasheh afat jo më shumë se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AK-së dhe pasoja për mosdorëzim. **Nga ky formulim del se dorëzimi i vërtetimit pas hapjes së ofertave nuk është, i vetëm, shkak i mjaftueshëm eliminimi. Megjithatë, kjo dispozitë nuk përjashton detyrimin për të provuar se kushti material i pranueshmërisë ka qenë i përmbushur në kohën relevante.**

Bazuar ne Nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së trajton operatorin që "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ...", me përjashtimin e paraparë në vetë dispozitën. Neni 25.6(d) i Rregullores Nr. 001/2022 kërkon si dëshmi për tatimet një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore. **Kërkojmë që AK të vlerësojë përmbajtjen dhe efektet juridike të dokumenteve të ATK-së, e jo vetëm datën e lëshimit të vërtetimit të fundit**.

Marrëveshja e datës 08.05.2026, vërtetimi i datës 01.07.2026, marrëveshja e datës

19.10.2026 dhe vërtetimi i datës 22.10.2026 duhet të shqyrtohen në lidhje me njëri-tjetrin. **Kërkojmë verifikim nga ATK nëse marrëveshja e parë ka qenë aktive dhe është respektuar më 24.09.2026 dhe më 15.10.2026**, si dhe nëse marrëveshja e re përbën vazhdimësi apo rregullim të një detyrimi tjetër. Vetëm data e marrëveshjes së re nuk mjafton për të konstatuar se operatori ka qenë i papranueshëm në datën e hapjes.

Theksojmë se neni 65, paragrafi 4.3 i LPP-së përmban edhe një shkak të veçantë papranueshmërie lidhur me marrëveshjet me kreditorë në rrethana të caktuara. Për këtë arsye nuk pretendojmë se çdo marrëveshje me këste përjashton automatikisht zbatimin e nenit 65; kërkojmë vlerësim të saktë të natyrës juridike dhe statusit të marrëveshjes tatimore.

Referimi i përgjithshëm në interpretimin nr. 6 të KRPP-së dhe në vendime të paidentifikuara të OSHP-së **nuk e zëvendëson** arsyetimin konkret mbi dokumentet e këtij operatori. Kërkojmë të na komunikohen teksti i plotë i interpretimit, vendimet përkatëse të OSHP-së dhe arsyet pse rrethanat e tyre janë të krahasueshme me këtë rast. Autoriteti duhet të sqarojë edhe dispozitën e dosjes së tenderit që përcakton datën relevante dhe vlefshmërinë e dëshmisë së ATK-së.

Vërtetimi i mëhershëm ishte lëshuar para njoftimit për kontratë afati i tij ka vlefshmërisë prej 90 ditë, ai do të mbulonte datën 24.09.2026, Kërkojmë që AK të vlerësojë dokumentin në raport me kushtin e përcaktuar në dosjen e tenderit.

• kërkojmë Të aprovohet Ankesa ar dhe të anulohet vendimi i eliminimit, pasi qe verifikimi tek dukomnetet egzistues rezulton se kushtet e pranueshmërisë janë te përmbushur.

Letra B42 e datës 26.10.2026; njoftimi për kontratë i datës 24.09.2026; procesverbali i hapjes 15.10.2026; marrëveshjet ATK të datave 08.05.2026 dhe 19.10.2026; vërtetimet ATK të datave 01.07.2026 dhe 22.10.2026;,

Duke pare se shume autoritete kontraktuese nuk e pranojne Vertetimin tatimor te skaduar pasi qe vertetimi tatimor i cili ne e kemi pasur eshte i dates 01.07.2026 dhe se data kur eshte kerkuar nga autoriteti kontraktues per vertetimin tatimor ishte i skaduar, ne kemi ofruar marrveshjen e re me date 22.10.2026

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe faktet te cilat u ceken me larte, kerkojme nga ju si Autoritet Kontraktues qe te nxejrrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kerkesa per rishyrtim e AJANI & ADAMI SH.P.K

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-se per dhenie te kontrates dhe lenda te kthehet ne ri-vlersim dhe gjate ri-vlersimit, ekzaminimit, vlersimit dhe krahasimit ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrat dhe konform dispozitave te LPP-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na jane bere deme materiale per pergaditjen dhe dorzimin e ofertes, per kerkesen per rishqyrtim dhe mundesine e dergeses se lendes ne OSHP

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*